



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 549/ 2010

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga, Ferit Osmani kryesues, Vlastimir Dimić dhe Nehat Idrizi, duke vendosur përkitazi për ankesën e subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Komisionit Komunal Zgjedhor (KKZ) për shkak të parregullsive gjatë procesit zgjedhor, në seancën e panelit të mbajtur me 15.12.2010, mori këtë:

## V E N D I M

**REUZOHET** ankesa si e pabazuar e subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK).

## A r s y e t i m

PZAP, ka pranuar një ankesë më datë 13.12.2010, nga subjektit politik AAK, ne te cilën pretendohet se në Qendrat e Votimit (QV), 2710b, 2710b, 2711b, 2717b, 2704b, 2702b dhe 2713b, ka pasur mospërputhje te numrit të votuesve dhe fletëvotime të mbushura në kuti. Parashtruesi i ankesës nuk ka bashkangjitur asnjë provë.

Neni 118 paragrafi 1 i LZP-së, parasheh:

*118.1 PZAP-i pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk përmbushin standardet*

Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, neni 3 paragrafi 6 pika (c) parasheh:

- (c) *hollësi rreth çfarëdo dëshmie dhe kopje të çfarëdo dokumentacioni relevant apo dëshmi të tjera në posedim të ankuesit ose udhëzime se ku mund të gjenden dëshmitë, në rastet kur të njëjtat nuk janë në posedim të ankuesit.*

PZAP-i pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

- **ankesa është e pabazuar.**

Pretendimet nga parashtruesi i ankesës janë te pabazuara për shkak se nuk janë ofruar dëshmi për të besuar se ka pasur një mospërputhje midis numrit te votuesve dhe

fletëve të votimit në QV-te e përmendura më lartë. PZAP-i duke u bazuar në këto arsye e po ashtu në pajtim me dispozitat e cituara ligjore si dhe në kuptim të nenit 115 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtesa**

A nr. 549/2010 më datën 15.12.2010.

